



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E PATOS

KRYETARI
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Patos, më 25/09/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje bazë materiale për ndriçimin rrugor

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shtylla për ndriçim rrugor me Kod 34928510-6, Ndricues rrugor me Kod34993000-4,

Materiale elektrike me Kod 31681410-0,

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,872,440 (tre milion e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e dyzetë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat lokale 2023.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Patos** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1.Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **1,548,976 (një milion e pesëqind e dyzetë e tetë e mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë)** lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

3,872,440 x 40% = 1,548,976 Lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për

“Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (*apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot*).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

3,872,440 x 20% = 774,488 Lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të vetdeklaroj (me anë të një dekalrate) se ofron garanci 1 vjeçare për ndriçuesat LED dhe 1 vit për bateritë e ndriçuesit LED me panel diellor.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”. Ky

vetdeklarim kërkohet për të vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponoj në pronësi ose me qera, mjetet e mëposhtme:

- Mjet vetshkarkues me kapacitet mbajtës **mbi 5 ton** **copë 1**

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose qera (me kontratë noteriale), duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë,
- siguracionin e mjetit,
- kolaudimin,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit të paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit).

Për mjetet dhe pajisjet të cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,
 - fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimit të mjetit.
- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme), të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 5/ç nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Këto mjete janë kërkuar nisur nga sasia e konsidueshme e mallrave objekt prokurimi, vendodhjet e ndryshme të objekteve ku do të vendosen materialet.

2.3.4. Operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar për mallrat e kërkuara objekt prokurimi.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 5/a dhe pika 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

2.3.5. Operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e **06/10/2023 ora 11:00**, (para hapjes së fazës së vlerësimit nga KVO përkatëse) mostrat për zërat si më poshtë:

Nr.	Nr. Anal.	Emertimi	Njesia	Sasia
1	treg	Ndriçues LED 50 W	copë	1
2	treg	Ndriçues LED 100 W	copë	1
4	treg	Ndriçues LED me Panel diellor	copë	1

Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për rëndësinë e mallrave dhe përshtatshmerinë që duhet të kenë në objektet ekzistuese ndaj është e nevojshme sjellja e mostrave.

Shënim: Ky kriter përbën kusht skualifikimi në rast se mostrat e dorëzuara nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Mosparaqitja mostrave përbën kusht për skualifikim. Mostrat e dorëzuara do ti kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostra i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 6 gërma a, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: *6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimet teknike u hartuan nga **Drejtoria e planifikimit urban, projekteve, shërbimeve dhe emergjencave civile** duke marr ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, ne perputhje me percaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” te ligjit nr.162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, e nenit 40 pika 2, si edhe te nenit 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

- **Ndriçuesit Led 100 W**

Ndriçuesit që do të blihen duhet të jenë sipas karakteristikave që jepen si më poshtë:



(Foto ilustruese)

Shpërndarja e dritës	$\geq 130 \times 75^\circ$
Fluksi i ndriçimit	më e madhe se 11000 lm
Fuqia	100 W
Lloji i ndriçimit	LED
Temperatura e ngjyrës	4000 K
Niveli i tensionit	100- 265 V
Frekuenca	50Hz
Shkalla e mbrojtjes	IP-66
Shkalla e mbrojtjes nga goditjet	IK08
Materiali	Alumin
Dimensionet	$\leq 455 \times 165 \times 70$ mm

Ndriçuesit nuk do të pranohen nga komisioni nëse nuk plotësohen specifikimet teknike të mësipërme.

- **Ndriçuesit Led 50 W**

Ndriçuesit që do të blihen duhet të jenë sipas karakteristikave që jepen si më poshtë:



(Foto ilustruese)

Shpërndarja e dritës	$\geq 130 \times 75^\circ$
Fluksi i ndriçimit	më e madhe se 6000 lm
Fuqia	50 W
Lloji i ndriçimit	LED
Temperatura e ngjyrës	4000 K
Niveli i tensionit	100- 265 V
Frekuenca	50Hz
Shkalla e mbrojtjes	IP66
Shkalla e mbrojtjes nga goditjet	IK08
Materiali	Alumin

Dimensionet

≤ 390x 155x 55 mm

Ndriçuesit nuk do të pranohen nga komisioni nëse nuk plotësohen specifikimit teknike të mësipërme.

- **Ndricues LED me panel diellor 70W**

Ndriçuesit që do të blihen duhet të jenë sipas karakteristikave që jepen si më poshtë:



(Foto ilustruese)

Shpërndarja e dritës	≥ 120°
Autonomia	≥ 12 ore
Fluksi i ndriçimit	≥ 2900 lm
Fuqia	70 W
Lloji i ndriçimit	LED
Temperatura e ngjyrës	6500 K
Shkalla e mbrojtjes	IP65
Materiali	Alumin
Qeliza fotovoltaike	monokristaline nga te dyja anet
Lloji Baterisë	LiFePO4

Ndriçuesi duhet të jetë me sensor të lëvizjes dhe kur të detektohet lëvizja ndriçimi duhet të jetë 100% të fluksit të dritës, në rastet kur nuk detektohet lëvizje fluksi i ndriçimit duhet të ulet dhe të jetë ≤ 10%.

Paneli fotovoltaike duhet të jetë pjesë e ndriçuesit dhe jo i shkëputur nga ndriçuesi.

Bateria duhet të jetë me 1 vit garanci dhe të jetë lehtësisht e aksesueshme dhe lehtësisht e ndryshueshme pa patur nevojë për specializim shtesë të elektrikistit.

Ndriçuesit nuk do të pranohen nga komisioni nëse nuk plotësohen specifikimit teknike të mësipërme.

- **Ndriçuesit Led 50 W rrethor.**

Ndriçuesit që do të blihen duhet të jenë sipas karakteristikave që jepen si më poshtë:



(Foto ilustruese)

Fluksi i ndriçimit	≥ 6000 lm
Fuqia	50 W
Lloji i ndriçimit	LED
Temperatura e ngjyrës	4000 K
Niveli i tensionit	220- 240 V
Frekuenca	50Hz
Shkalla e mbrojtjes	IP65
Materiali	Alumin

Ndriçuesit nuk do të pranohen nga komisioni nëse nuk plotësohen specifikimit teknike të mësipërme.

- **Shtylla konike me një krahë për ndriçim rrugor 7.8 m.**

Shtyllat që do të blihen duhet të jenë sipas karakteristikave që jepen si më poshtë:

Lartësia e shtyllës	7.8 m
Spesori	3 mm
Shkalla e mbrojtjes	Ip65
Forma e shtyllës	konike
Materiali	Çelik i galvanizuar

- **Krahë**

Materiali:	Çelik i galvanizuar
Përmasat:	D60 1000 x 1000

Montimi: Në shtyllë cilindrike ose konike.

- **Kapak shtylle**

Kasetat metalike duhet të jenë hermetike e shoqëruar me guarnicion.

Përmasat: 45x 186 (ose të përafërta)

- **Qafore**

Material: Çelik i galvanizuar

Përmasat: D 160

- **Nastro**

Material: Tekstil

Tipi: Izolant elektrik

Gjerësia: 19 mm

Gjatësia: 20 m

Shënim: Baza materiale do të dorëzohet nga operatori me dokumentacionin teknik përkatës sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **06/10/2023, ora 11:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me **objekt “Blerje bazë materiale për ndriçim rrugor”**.

Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT